



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME TEKNIKE EKONOMIKE DHE HOTELERI – TURIZËM
“ANTONI ATHANAS” SARANDË

Nr. 163 Prot.

Sarandë, më : 14/11/2025

Lënda : Njoftim për **lëvizje paralele**.
Drejtuar: Drejtorisë Juridike
Drejtorisë Burimeve Njerezore
Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive

Tiranë

Në zbatim të Ligjit 7961 date 12/07/1995 “ Kodi I Punes ne Republiken e Shqiperise , ligjit Nr. 15/2019 “Për nxitjen e Punësimit”, Ligjit nr. 15 datë 16/02/2017 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.07.2019 “Për Krijimin, Mënyrën e Organizimit dhe të Funksionit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, të Udhëzimit **Nr. 759, datë 30.09.2024**”Për Mënyrën e Organizimit dhe Veprimtarisë së Institucioneve të Arsimit dhe Formimit Profesional, si dhe Aspektet e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore , Përbërjes së Njësive të Zhvillimit të Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Zhvillimit të Vazhduar Profesional të Personelit”, “ Shkolla e Mesme Profesionale : “Antonio Athanas”, Sarandë , ju njofton për krijimin e nje vendi të lire pune në bazë të Urdhërit nga MEI nr.25 datë 31.10.2025 me Nr.276/3 Prot date 31.10.2025 (për nje mesues me kohë të pjesshme) në pozicionin ”Mësues të kulturës profesionale” në profilin mësimor dy vjecar pas të mesmes “Ndërmjetësimin e Pasurive të Paluajtshme”Aplikanti duhet të përmbushë këto kriterë:

1. Kriteret të përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të

2. Kriteret të posaçme për personelin mësimdhënës të formimit teorik-praktik në ofruesit e formimit profesional:

- a) të ketë diplomë të nivelit master profesional *ose* të barazvlefshme, në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së **profili: Arkitekt (një)**
- b) të ketë të paktën *1 (një) vit përvojë* pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

Dokumentet e aplikimit.

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- Letërmotivimin për pozicionin;
- Jetëshkrimin (Cv-ne sipas shtojcës 11 të udhëzimit **nr. 759, datë 30.09.2024**)
- Kartën e identitetit;
- Diplomën;
- Librezën e punës;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet , trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- Certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- Vërtetimin e gjëndjes shëndetësore;
- Vërtetimin e gjëndjes gjyqësore;
- Vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij ,nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
- Të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara; Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së brenda datës 25.11 .2025.

Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet referuar përcaktimeve të udhëzimit nr.759 datë 30.09.2024 “për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësive së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”



Drejtori
Rudina Liçaj